



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1752/3 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM

Nr.249, datë 29.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 86, DATË 18.04.2017,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË PËRMET**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 86, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017”, në Bashkinë Përmet,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 83, datë 20.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Përmet, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit në Bashkinë Përmet, prej datës 27.04.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 86, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Përmet, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për 6 (gjashtë) punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 267, datë 18.10.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “Përgjegjës dhe Koordinator në Zyrën e Ndhmës Ekonomike dhe PAK”;

- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 15, datë 31.01.2017, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Ekonomist për Prokurimet”;
- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 14, datë 31.01.2017, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Tatim-Taksa”;
- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 36, datë 06.03.2017, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Programim Zhvillimit”;
- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 139/1, datë 06.05.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist PAK”;
- ✓ Të anulojë aktin administrativ nr. 141, datë 06.05.2016, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Punonjës i Ndhmës Ekonomike”.

2. Njësia përgjegjëse të hartojë planin e punës së pranimeve në shërbim civil për vitin 2017, duke përfshirë pozicionet e punës më sipër, si dhe pozicionet e punës të plotësuar në kundërshtim me ligjin, të cilat janë evidentuar dhe trajtuar më parë nga Komisioneri në Vendimin Nr. 83, datë 20.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334, datë 18.04.2016”, dhe që njësia përgjegjëse nuk i ka plotësuar ende me anën e procedurave të konkurrimit.

3. Njësia përgjegjëse, të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke e ndarë në dy faza.

4. Pozicionet në fjalë duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

5. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ *Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përherhëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.*
- ✓ *Të bëhen publike në faqen zyrtare “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:*

a) Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.

b) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.

c) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.

d) Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

6. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Përmet, të fillojë zbatimin e vendimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 86, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të

verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017”, me Vendimin Nr. 222, datë 31.10.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 86, datë 18.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017’”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 86, datë 18.04.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Migena Haznedari, Joni Marko dhe Stela Ndoka, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 09.11.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Përmet.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Përmet dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1752/2 prot., datë 31.10.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 09.11.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Përmet, Përgjegjësit të Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Arsimit.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me emërimin në kundërshtim me ligjin të 6 punonjësve (*****), të anulojë aktet e tyre të emërimit.

Nga verifikimi në subjekt dhe komunikimi me njësinë përgjegjëse të institucionit (njësinë e burimeve njerëzore), rezultoi se Kryetari i Bashkisë Përmet me Urdhrin nr. 139, datë 12.07.2017, “Për shfuqizimin si të paligjshëm të aktit administrativ Urdhër nr. 15, datë 31.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë”, ka urdhëruar shfuqizimin e aktit të emërimit në detyrë të punonjësit Th. Kosta, si akt i dalë në kundërshtim me ligjin. Pozicioni i punës “*Ekonomist për Prokurimet*” i mbajtur nga ky punonjës, nuk ekziston më në strukturën aktuale të Bashkisë Përmet, miratuar me Urdhrin Nr. 135, datë 10.07.2017, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë”.

Në momentin e verifikimit në subjekt, për 5 rastet e tjera, Kryetari i Bashkisë Përmet nuk kishte marrë masa për anulimin e akteve të paligjshme të emërimit, duke pretenduar se për shkak të kohës që nevojitej për plotësimin e pozicioneve të lira në përputhje me ligjin do të krijoheshin pengesa në mbarëvajtjen e punëve të institucionit.

Ndërkohë, sikundër do të parashtrohet në vijim, këto pozicione janë shpallur si të lira, nga njësia përgjegjëse.

Në zbatim të **pikës 2 të vendimit** paralajmërues, njësia përgjegjëse e Bashkisë Përmet me Vendimin Nr. 172, datë 09.08.2017 “*Plani Vjetor i Pranimeve në Shërbimin Civil të Bashkisë Përmet për vitin 2017*”, ka hartuar planin e punës së pranimeve në shërbimin civil në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 26.02.2014, “*Për planin vjetor të pranimet në shërbimin civil*”, duke përfshirë në të edhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin. Tre nga këto pozicione kanë ndryshuar emërtesë në strukturën aktuale të Bashkisë Përmet, miratuar me Urdhrin Nr. 135, datë 10.07.2017. Konkretisht,

- Pozicioni “*Përgjegjës dhe Koordinator në Zyrën e Ndhmës Ekonomike*”, ka ndryshuar emërtesë në “*Koordinator Shoqëror (NE dhe PAK)*”;
- Pozicioni “*Specialist PAK*” ka ndryshuar emërtesë në “*Administrator Shoqëror NE*”;
- Pozicioni “*Punonjës i Ndhmës Ekonomike*” ka ndryshuar emërtesë në “*Administrator Shoqëror PAK*”.

Këto ndryshime janë pasqyruar si në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil ashtu edhe në shpalljet e vendeve të lira të dërguara pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Në pikat 3, 4 dhe 5 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse që anulimi i akteve të emërimit të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe plotësimin e tyre me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore përkatëse.

Me shkresën nr. 1645 prot., datë 31.10.2017, “*Ridërgohet njoftim për shpallje*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njësia përgjegjëse ka dërguar pranë këtij të fundit shpalljet e **5 (pesë)** pozicioneve (“*Koordinator shoqëror (NE dhe P.A.K)*”, “*Specialist Tatim-Taksa*”, “*Përgjegjës i Sektorit të Programit-Zhvillimit*”, “*Administrator Shoqëror P.A.K*”, “*Administrator Shoqëror i Ndhmës Ekonomike*”; Pozicioni “*Ekonomist për Prokurimet*” nuk ekziston më në strukturë).

Në vijim të procedurave të konkurrimit njësia përgjegjëse me Urdhrin nr. 220, datë 06.11.2017, ka ngritur “*Komisionin e Përhershëm të Pranimet në Shërbimin Civil*” dhe me Urdhrin nr. 220/1 prot., datë 06.11.2017, “*Për krijimin e komitetit të pranimet të ngritjes në detyrë për pozicionin “Përgjegjës Programim Zhvillimi”*”

Me shkresën nr. 1829 prot., datë 24.11.2017, “*Dërgim listë të kandidatëve*”, Bashkia Përmet ka njoftuar **Shërbimin Kombëtar të Punësimit** për listën e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin për procedurën e pranimet në shërbimin civil për pozicionet: “*Koordinator shoqëror (NE dhe P.A.K)*”, “*Specialist Tatim-Taksa*”,

*“Përgjegjës i Sektorit të Programit-Zhvillimit”, “Administrator Shoqëror P.A.K”,
“Administrator Shoqëror i Ndhmës Ekonomike”.*

Në përfundim të procedurave të konkurrimit, njësia përgjegjëse duhet të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil aktet e shpalljes së kandidatëve që janë shpallur fitues me më shumë se 70% të pikëve.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 86, datë 18.04.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e lëna nga Komisioneri.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 86, datë 18.04.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 23, datë 10.02.2017”*, në Bashkinë Përmet.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Përmet, duke zbatuar Rekomandimet e Vendimit Nr. 86, datë 18.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Përmet dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha